



Procesverbal i Dëgjimeve për
Buxhetin
e vitit 2024 dhe Kornizën
Afatmesme Buxhetore (KAB)
2024-2026
në
**Objektin e Shkollës “Gëzim
Hamza”, Rahovec**

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2024 dhe KAB-in për vitet 2024-2026, u publikua me datë: 28.07.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

*Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës Rahovec, Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: **14.08.2023**, deri më datë: **18.08.2023** nën organizimin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës Rahovec, do të organizohen njëmbëdhjetë (11) dëgjime publike buxhetore.*

*Dëgjimi publik me qytetarët e komunitetit joshumicë, për planifikimin e buxhetit për vitin **2024** dhe KAB-in për vitet **2024-2026**.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendari i dëgjimeve buxhetore për njëmbëdhjetë (11) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> më datë: 28.07.2023.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar OJQ-të, Bizneset dhe Grupet e Interesit, Buxhetimi Gjinnor ku janë janë të informuar edhe gjinia **femërore**, si dhe Bashkësitë Lokale dhe lagjet urbane përfaqësuesit të shkollave dhe rininë, rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb - faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit **me** qytetarët e komunitetit joshumicë, u publikua më datë 07.08.2023, në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/degjime-buxhetore-al/njoftime-degjime-buxhetore/>

Njoftimet, përveç që janë publikuar në ueb-**faqe të** Komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social *Facebook*, u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale *Viber dhe WhatsApp*.

DËGJIMI PUBLIK ME *qytetarët e komunitetit joshumicë*

Me Qytetarët e komunitetit joshumicë që veprojnë në Komunën Rahovec, u mbajt më: 15.08.2023, në objektin e Shkollës Filllore Gëzim Hamza në Rahovec, me fillim në ora 11:00.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga Grupi punues dhe zyrtarë komunalë, ishin: 6

- Femra ishin: 3,
- Meshkuj ishin: 3.

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 21

- Femra ishin: 9,
- Meshkuj ishin: 12.

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgimin e shpalli të hapur drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, Afrim Limani.

Afrim Limani: Përsëritet për të gjithë të pranishmit, të nderuar përfaqësues të *komunitetit joshumicë*, ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu!

Jemi sot këtu në dëgimet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja si *qytetarë të komunitetit joshumicë*, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2024.

Buxheti për vitin 2024 do të jetë: 20,034,785.00 euro, **Paga dhe mëditje** në vlerë prej 10,300,983.00 euro, **Mallra dhe Shërbime** në vlerë prej 2,466,340.00 euro, **Shërbime Komunal** në vlerë prej 370,000.00 euro, **Subvencione dhe Transfere** në vlerë prej 890,000.00 euro, si dhe **Investimet Kapitale** kapin vlerën prej 6,007,462.00 euro.

Ju lus që kërkesat, edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokolluara t'i sillni dhe në Komunë, që më pas të cedohen nëpër drejtoritë përkatëse. Nëse ka dikush nga kolegët e Grupit punues, mund të bashkëngjiten, nëse jo, urdhëroni ju përfaqësues të *komunitetit joshumicë*.

Ardiana Kryeziu, qytetare e Rahovecit: të nderuar, përsëritet, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Mungesa e banimit, sepse jemi shumë anëtarë të cilët jetojmë në një dhomë.

Xhemajli Isaku, qytetar i Rahovecit: të nderuar, përsëritet, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Mungesa e ndriçimit publik afër shkollës dhe
- Mungesa e parkingut afër Shkollës "Gëzim Hamza".

Xhevat Hasani, qytetar i Rahovecit: të nderuar, përsëritet, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Mungesa e kanalizimit në lagjen e komunitetit, afër Shkollës "Gëzim Hamza",
- Ndërtimi i një parku në lagjen e komuniteteve.

Afrim Limani: Faleminderit juve përfaqësues të *komunitetit joshumicë* që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 14:50

Rahovec, 15.08.2023

Ekrem Bytyçi
Kryesues i Grupit Punues